



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1595 Prot.

Tiranë, më 18. 10. 2019

V E N D I M

Nr. 148, Datë 18. 10. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 43, datë 08.05.2019, e shtetasit F. Ç., përfaqësuar me prokurë të posaçme¹ nga A. K., kundër Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Komanda Mbështetëse, Reparti Ushtarak Nr. 4030, Ministria e Mbrojtjes, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër*².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi shpjegon se gjatë periudhës 2016-2017, ka ushtruar detyrën e Specialistit të Transportit, në Repartin Ushtarak Nr. 4030, nën varësi të Komandës Mbështetëse, Shtabi të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes. Aktualisht ankuesi është në rezervë dhe trajtohet me pagesë kalimtare pranë Repartit Ushtarak Nr. 6670. Pas largimit nga pozicioni i punës, më datë 20.09.2018, është njoftuar nëpërmjet shkresës Nr. 417 prot., (pasi bashkëshortja e tij, pjesë e Forcave të Armatosura, ka marrë dënim në rrugë informale mbi një auditim të kryer në Repartin

¹ Nr. 681 Rep., Nr. 157 Kol., datë 02.05.2019

² Për më shumë se një herë i është drejtuar institucionit, përfshirë dhe Ministrin të Mbrojtjes për ta vënë në dijeni lidhur me praktika anti ligjore dhe procedura të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin nga Reparti Ushtarak 4030

Ushtarak Nr. 4030 dhe ka kërkuar dokumentacionin përkatës për këtë procedurë audituese), se në cilësinë e kryetarit të komisionit të ndërrimit të gomave pranë Repartit Ushtarak Nr. 4030, ka rezultuar në shkelje dhe është rekomanduar marrja e masave për arkëtimin e shumës 33.000 lekë. Sipas ankuesit e gjithë procedura e ndjekur nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, është kryer pa vënë në dijeni ankuesin për asnjë nga procedurat e ndjekura prej tyre.

Në vijim ankuesi sqaron se, në cilësinë e kryetarit të komisionit të ndërrimit të gomave (komisioni i përbërë nga 5 persona), kishte për detyrë të bënte vlerësimin e nevojave të pajisjes së mjetit me goma (sipas Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 167, datë 10.04.2003 “Për miratimin e normave të përdorimit të gomave dhe baterive në automjetet e FA”) dhe pas kësaj urdhëronte magazinierin e Batalionit të Mbështetjes Rajonale Tiranë për t’i dhënë atij të ish DMR³-së Korçë 4 goma. Më pas, procedurën për kalimin e gomave nga BMR Tiranë në ish DMR Korçë, e kryenin magazinierët e BMR-së dhe DMR-së. Sipas ankuesit, Njësia e Auditimit ka konstatuar mungesën e 2 gomave dhe ka vendosur në mënyrë selektive në ngarkim të tij dhe magazinierit të ish DMR-së Korçë, kthimin e dëmit financiar për vlerën e 2 gomave të tjera.

Në muajin Gusht 2018, ka vërë re se nga pagesa kalimtare që përfitonte nga Forcat e Armatosura, ishte bërë një ndalesë prej 5000 lekë në llogarinë e tij në bankë. Pasi është interesuar për këtë ndalesë, ka marrë dijeni se si rezultat i procesit të auditimit të kryer, çdo muaj nga llogaria tij mbahej diferenca për të likuaduar shumën totale prej 33.000 lekë të rekomanduara nga Njësia e Auditimit. Në këto kushte, me anë të shkresës datë 16.10.2018, i është drejtuar Ministrit të Mbrojtjes lidhur me këtë situatë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Në përfundim, ankuesi sqaron se për më shumë se një herë i është drejtuar institucionit, përfshirë dhe Ministrit të Mbrojtjes për ta vënë në dijeni lidhur me praktika anti ligjore dhe procedura të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin nga Reparti Ushtarak 4030. Përsa më lart, këto veprime të ankuesit kanë bërë që ai të ngarkohet nga Njësia e Auditimit, si i vetmi përgjegjës nga 5 persona që përbëhej komisioni, për kthimin e shumës financiare dhe mungesën e 2 gomave.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të konstatojë diskriminimin e tij dhe të rekomandojë heqjen e masës administrative të vënë nga Njësia e Auditimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,*

³ Shkurtim i Detashmenti i Mbështetjes Rajonale

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me anë të shkresës Nr. 682/1 prot., datë 23.05.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjekteve, ku i ka kërkuar informacion lidhur me pretendimet për diskriminim, të subjektit ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Mbrojtjes me anë të shkresës Nr. 234/2 prot., datë 05.06.2019, vuri në dispozicion të KMD-së informacion lidhur me pretendimet e palës ankuese, duke sqaruar ndër të tjera se: “Grupi i Auditimit ka ushtruar angazhimin e tij në Batalionin e Mbështetjes Rajonale në zbatim të punës së miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, lidhur me vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko financiare në Batalionin e Mbështetjes Rajonale për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2017. Nga auditimi i shërbimit të teknikës është konstatuar se automjeti tip Benz 508 me targë MM 554 KM sipas proces verbalit Nr. 1, datë 19.04.2017 i janë vendosur 4 goma të reja, kurse nga verifikimi në vend i procedurës rezultoi se automjetit i ishin vendosur 2 goma të reja dhe jo 4. Të ndodhur pranë kësaj shtate të krijuar si rezultat i mashtrimit nga ana e komisionit me qëllim përfitimit të vlerës 33.000 (çmimi/2 goma) auditi ka ngarkuar me përgjegjësi gjithë komisionin e procesverbalit për shlyerjen e detyrimit, ndërkohë në fazën e shqyrtimit të projekt raportit dolën në dritë fakte të reja që implikonin Kapiten F. Ç në cilësinë e kryetarit të komisionit dhe Tetar A. A., pasi anëtarët e tjerë pohojnë se firma e tyre është falsifikuar. Për këtë arsye auditi ka gjykuar që kjo shumë të arkëtohet në emër të tyre. Lidhur me pretendimin për mosnjohim, sqarojmë se ky pretendim i F. Ç. nuk qëndron pasi për këtë problem është njoftuar dhe nga auditi dhe nga komandanti i repartit, brenda

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

ambjenteve të repartit, përpara dërgimit të raportit përfundimtar në këtë subjekt. Për kryerjen e angazhimit të auditimit në këtë njësi nga ana e grupit të punës janë zbatuar me korrektësi të gjitha hapat e përcaktuara në Ligjin 'Për auditimin e brendshëm në sektorin publik' dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe jemi të hapur për çdo ballafaqim me F. Ç.'. Në përfundim të përgjigjes, Ministria e Mbrojtjes ka cituar se ka dërguar bashkëngjitur shkresës 3 dokumenta në cilësinë e provave, por asnjë prej tyre realisht nuk ishte bashkëngjitur.

2. Përsa i përket subjektit Reparti Ushtarak Nr. 4030, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dërgoi 2 (dy) herë me anë të postës zyrtare kërkesë për informacion lidhur me pretendimet e subjektit ankues, por në të 2 rastet posta ka kthyer zarfin e shkresës, për shkak të adresës së pasaktë (e cila ishte marrë nga dokumentacioni zyrtar të dorëzuar nga pala ankuese tek KMD).
3. Për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës Nr. 682/3 prot., datë 16.07.2019, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 23.07.2019, ora 10:00.

Seanca u zhvillua në datën 23.07.2019, me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues, përfaqësuar me prokurë të posaçme⁵ nga A. K. dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit të Ministrisë së Mbrojtjes I. P. Ndrësa nga ana e Repartit Ushtarak Nr. 4030, nuk u paraqit asnjë përfaqësues për shkak se adresa ka qënë e pasaktë dhe njoftimi ishte kthyer nga ana e Postës Shqiptare.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të rregjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët ndaj i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Fillimisht përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes, sqaroi se kishte qënë një prej anëtarëve të grupit të Auditit të kryer pranë Repartit Ushtarak Nr. 4030. Sipas tij, auditimi në Repartin Ushtarak Nr. 4030, kishte qënë një procedurë e programuar më parë dhe nuk ishte një kontroll i befasishëm. Gjatë procedurës së auditimit, grupi i auditit ishte njohur me problematikën e humbjes së dy gomave. Pas këtij informacioni, grupi i auditit kishte verifikuar informacionin e marrë në rrugë verbale dhe kishte konstatuar se automjetit tip Benz 508 me targë MM 554 KM i ishin vendosur 2 goma të reja dhe jo 4, si citohej në dokumentacionin e verifikuar. Në këtë situatë, në Projekt

⁵ Nr. 681 Rep., Nr. 157 Kol., datë 02.05.2019

Raport auditit fillimisht kishte ngarkuar me përgjegjësi të gjithë komisionin e ndërrimit të gomave për shlyerjen e detyrimit, për 2 gomat që nuk i ishin vënë automjetit. Projekt Raporti i Auditit i ishte dërguar Komandantit të Repartit Ushtarak Nr. 4030, në mënyrë që të gjithë punonjësit të cilët ishin ngarkuar me përgjegjësi të bëheshin me dije dhe të bënin observacionet e tyre nëse nuk binin dakord me gjetjet e Grupit të Auditit. Sipas z. I. P., Komandanti i Repartit Ushtarak Nr. 4030, kishte detyrimit të bënte me dije të gjithë personat e ngarkuar me përgjegjësi nga auditimi i kryer. Në vijim, 2 prej anëtarëve të komisionit të ndërrimit të gomave kishin bërë observacionet e tyre duke pohuar se nuk kanë qënë në dijeni të procedurës së kryer për ndërrimin e gomave dhe kanë pretenduar se firma e tyre është falsifikuar në procesverbalin e mbajtur. Sipas z. I. P., duke qënë se gjatë procedurës së auditit, Grupi i Auditit, kishte marrë verbalisht informacion nga ankuesi dhe shtetasi A. A., se kanë qënë ata që kanë mbajtur 2 prej gomave të cilat mungonin. Në këto kushte, Grupi i Auditit në Raportin Përfundimtar, kishte ngarkuar me përgjegjësi F. Ç. dhe shtetasin A. A., duke vendosur që vlera e 2 gomave t'i kthehet Repartit Ushtarak Nr. 4030 nga këta punonjës.

Në përfundim të seancës dëgjimore, u depozituan akte shpresore të cilat u administruan në cilësi prove dhe iu bashkëlidhën akteve të dosjes së ankuesit⁶, si dhe nga ana e përfaqësuesit të Ministrisë së Mbrojtjes, u ra dakord që në dispozicion të Komisionerit do të vendoset dosja e plotë e auditimit të kryer në Repartin Ushtarak Nr. 4030, por nuk u vu në dispozicion

4. Në vijim të procedurës, me anë të shkresës Nr. 682/4 prot., datë 27.08.2019, KMD ka kërkuar nga Reparti Ushtarak Nr. 4030, të vërë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, informacionin⁷ lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje të informacionit të kërkuar, Reparti Ushtarak Nr. 4030, me shkresën⁸ nr. 1658 prot., datë 02.09.2019, ndër të tjera sqaroi se: *“...F. Ç. ish punonjës në repartin tonë ka rezultuar debitor për vlerën 16.500 lekë, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit nr. 3998, datë 23.05.2018. Kjo debi ka lindur pasi sipas proces-verbalit nr. 01, datë 19.04.2017, automjetit Tip Benz 508-D me targë MM 554 KM, i janë vendosur 4 copë goma të reja. Nga kontrolli i ushtruar në objekt u konstatua se automjetit i janë vendosur 2 goma të reja. Vlera totale e këtyre 2 gomave është 33.000 lekë. Pas observacionit të anëtares së komisionit dhe drejtuesit të automjetit, grupi i auditit doli në përfundim se përgjegjësi për këtë problem duhet të mbajë*

⁶ Aktet janë cituar në vijim gjatë asrjetimit të vendimit.

⁷ - Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Kopje të Raportit të Auditit (vetëm ku konstatohen veprimet e kryera nga ankuesi).

- Kopje e vlerësimit të punës të subjektit ankues, nëse ka.

- Informacion nëse ka patur punonjës të tjerë të komisionit të ndërrimit të gomave të ngarkuar me përgjegjësi nga Grupi i Auditit.

- Informacion dhe kopje të dokumentacionit provues, nëse ankuesi është njoftuar apo ka qënë prezent gjatë procedurës së ndjekur nga Grupi i Auditit.

⁸ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 682/5 prot., datë 09.09.2019

kryetari i komisionit ish Kapiten F. Ç. dhe përgjegjësi material Tetar A. A. Për arkëtimin e vlerës 33.000 lekëmban përgjegjësi ish Kapiten F. Ç. në vlerën 16.500 lekë dhe Tetar A. A. në vlerën 16.500 lekë. Për ish Kapiten F. Ç. nga ana jonë u bë rregjistrimi në librin debitor (1/26/1) për vlerën 16.500 lekë dhe u dërgua te Reparti Ushtarak nr. 6670 (Qendra e Personel Rekrutimit) shkresa nr. 1450, datë 27.08.2018 ‘Kërkesë për marrje në evidencë debitor’. Reparti Ushtarak nr. 6670 e konfirmoj marrjen si debitor me shkresën nr. 6021, datë 05.06.2019 ‘Konfirmim marrje debitori’. Për tetar A. A. nga ana jonë u bë rregjistrimi në librin debitor (1/27/1) dhe u dërgua të Reparti Ushtarak nr. 6620 (Policia Ushtarake) shkresa 1451, datë 27.08.2018 ‘Kërkesë për marrje evidencë debitor’. Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 2162, datë 23.11.2017 ‘Për dalje në rezervë oficer aktiv’ Ish kapiten F. Ç. ka dal në rezervë dhe ka shkëputur marrëdhëniet financiare me repartin tonë më datë 30.11.2017. Në bazë të ligjit 10142, datë 15.05.2009 dosja e tij është dërguar në Repartin Ushtarak nr. 6670 (Qendra e Personel Rekrutimit) dhe nuk kemi kopje të vlerësimit të punës të subjektit ankues .”

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Reparti Ushtarak Nr. 4030, vuri në dispozicion të KMD-së:

- Kopje të Raportit të Auditit,
- Shkresën dërguar Repartit Ushtarak nr. 6670 (Qendra e Personel Rekrutimit) nr. 1450, datë 27.08.2018 “Kërkesë për marrje evidencë debitor”.
- Shkresën dërguar Repartit Ushtarak nr. 6670 (Qendra e Personel Rekrutimit) nr. 6021, datë 05.06.2019 “Konfirmim marrje debitori”.
- Shkresën dërguar Repartit Ushtarak nr. 6620 (Policisë Ushtarake) nr. 1451, datë 27.08.2018 “Kërkesë për marrje evidencë debitor”.
- Të dhënat personale.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

shtetasit F. Ç., në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative⁹, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030, të cilët duhet të provonin se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkaqet e pretenduara prej tij.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të japin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Gjatë periudhës 2016-2017, ka ushtruar detyrën e Specialistit të Transportit, në Repartin Ushtarak Nr. 4030, nën varësi të Komandës Mbështetëse. Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 2162, datë 23.11.2017 *“Për dalje në rezervë oficer aktiv”* ankuesi me dëshirë ka dal në rezervë dhe ka shkëputur marrëdhëniet financiare më datë 30.11.2017 me Ministrinë e Mbrojtjes. Në vijim ai është trajtuar me pagesë kalimtare pranë Repartit Ushtarak Nr. 6670.

Referuar provave¹⁰ të administruara, në muajin Prill 2017, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Gjendjes së Gomave të Automjeteve, i cili përbëhej nga 4 persona: ankuesi dhe shtetasit J. Q., Xh. L. dhe Sh. L. Nga ana e komisionit ishte bërë vlerësimi i nevojave të pajisjes me goma të mjetit Tip Benz 508-D me targë MM 554 KM (sipas Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 167,

⁹Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

¹⁰ Referuar procesverbalit Nr. 1, datë 19.04.2017

datë 10.04.2003 “Për miratimin e normave të përdorimit të gomave dhe baterive në automjetet e FA”) dhe ishte vendosur pajisja e tij me 4 goma të reja.

Në fillimin e vitit 2018, mbështetur në Programin e Punës, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes kishte realizuar një procedurë vlerësimi të veprimtarisë ekonomiko-financiare në Batalionin e Mbështetjes Rajonale. Gjatë auditimit të zhvilluar në Repartin Ushtarak Nr. 4030, Njësia e Auditimit ka konstatuar se mjetit Tip Benz 508-D me targë MM 554 KM, nuk i janë vendosur 4 goma të reja, siç ishte përshkruar në Procesverbalin nr. 1, datë 19.04.2017, por ishin vendosur 2 goma të reja.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit, Njësia e Auditimit, me shkresën nr. 3287 prot., datë 02.05.2018, ka dërguar pranë Reprartit Ushtarak nr. 4030, Projekt Raportin e Auditimit, ku në faqen 14 të tij, citohej se: “...Për këto mangësi mban përgjegjësi komisioni që ka nënshkruar proces verbalin nr. 1, datë 19.04.2017, i cili duhet të përgjigjet për vlerën e 2 gomave në shumën 33.000 lekë dhe njëkohësisht komandanti i batalionit të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë e komisionit për faktin që janë vendosur 2 goma dhe në proces verbal janë shënuar 4 goma...”. Gjithashtu, në shkresën e sipërcituar evidentohet se Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka sqaruar se: “...Me projekt raportin e auditimit duhet të njihen zyrtarisht të gjithë personat e atakuar, si ata që janë aktualisht në marrëdhënie pune, ashtu edhe ata që janë larguar nga ky institucion. Për mosnjohimin e këtyre personave ngarkohet me përgjegjësi drejtuesi i njësisë i cili e ka këtë detyrim sipas akteve ligjore në fuqi”.

Në vijim Reparti Ushtarak nr. 4030, me anë të shkresës nr. 819/1 prot., datë 17.05.2018, ka kthyer përgjigje Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, ku ka sqaruar ndër të tjera se: “...Me projekt raportin e auditimit u njohën të gjithë personat përgjegjës dhe të atakuar që janë në marrëdhënie pune me repartin tonë dhe në reparte të tjera të FA-së. Për personat që kanë shkëputur marrëdhëniet financiare po punojmë për gjetjen e adresave.”. Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, 2 nga anëtarët e komisionit të ndërrimit të gomave, J. Q. dhe Sh. L., kanë dërguar observacionet përkatëse në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm dhe kanë sqaruar se: “...ne nuk jemi në dijeni të këtij procesverballi ku thuhet se jemi anëtarë të komisionit dhe që kemi nënshkruar këtë dokument”.

Pas përgjigjes së marrë nga ana e Repartit Ushtarak nr. 4030 dhe shtetasve J. Q. dhe Sh. L., me shkresën nr. 3996 prot., datë 23.05.2018, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka dërguar pranë Repartit Ushtarak nr. 4030, Raportin Përfundimtar të Auditimit, ku në faqen 14 të tij citohet se: “...grupi i auditimit vlerësoi observacionin tuaj, realizoi ballafaqim për këtë problem me kryetarin e komisionit, Kapiten F. Ç., anëtarin J. Q., përgjegjës material të DMR Korçë, Tetar A. A., drejtuesin e automjetit Sh. L., takimit me komandantin e repartit dhe shefin e logjistikës, si dhe kqyrjen në vend të gomave, doli në përfundim se përgjegjësi për këtë problem duhet të mbajë kryetari i komisionit dhe përgjegjësi material.”. Në pikën 3 të faqes 22 të Raportit, citohet se: “Komandanti i Batalionit të Mbështetjes Rajonale Tiranë të marrë masa për arkëtimin e vlerës

prej 33.000 lekë nga ish Kapiten F. Ç., në cilësinë e kryetarit të komisionit të ndërrimit të gomave, pasi ka shkelur kërkesat e urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 167, datë 10.04.2013 'Për miratimin e normave të përdorimit të gomave e baterive të automjeteve' dhe Tetar A. A. për shkelje të pikës 36,38,39 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 'Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik'".

Në muajin Gusht 2018, referuar dokumentacionit të administruar, ankuesi kishte konstatuar se në llogarinë e tij në bankë është bërë një ndalesë prej 4800 lekë nga pagesa kalimtare që përfitonte nga Forcat e Armatosura.

Në rrugë jo zyrtare, bashkëshortja e subjektit ankues, është vënë në dijeni të procedurës së auditimit dhe ndalesave të bëra në llogarinë e ankuesit dhe i është drejtuar Repartit Ushtarak nr. 4030 me një kërkesë¹¹, ku ka kërkuar informacion mbi auditimin e kryer. Më datë 20.09.2018, nëpërmjet shkresës Nr. 417 prot., ka marrë dijeni se, ankuesi në cilësinë e kryetarit të komisionit të ndërrimit të gomave pranë Repartit Ushtarak Nr. 4030 dhe shtetasi A. A. në cilësinë e përgjegjës material të DMR-së Korçë, janë ngarkuar me përgjegjësi për zhdëmtimin e vlerës prej 33.000 lekë.

Përsa më lart, me anë të shkresës datë 16.10.2018, i është drejtuar Ministrit të Mbrojtjes lidhur me këtë situatë, ku ka kërkuar të rishikohet edhe një herë Raporti i Auditimit pasi nuk është dakord me të dhe nuk ka marrë asnjë dijeni lidhur me procedurën e auditimit apo me gjetjet e tij.

Në përfundim, ankuesi sqaron se për më shumë se një herë i është drejtuar institucionit, përfshirë dhe Ministrit të Mbrojtjes për ta vënë në dijeni lidhur me praktika anti ligjore dhe procedura të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin nga Reparti Ushtarak 4030. Përsa më lart, këto veprime të ankuesit kanë bërë që ai të ngarkohet nga Njësia e Auditimit, si i vetmi përgjegjës nga 5 persona që përbëhej komisioni, për kthimin e shumës financiare dhe mungesën e 2 gomave.

Lidhur me argumentimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030 se ankuesi ka marrë dijeni nga Njësia e Auditimit dhe Komandanti i repartit, brenda ambjenteve të repartit, përpara dërgimit të raportit përfundimtar,

Komisioneri konstaton se:

Së pari, nga këqyrja e akteve të administruara gjatë këtij procesi, nuk rezulton e provuar se subjekti ankues, të jetë vënë në dijeni nga ana e Njesisë së Auditimit apo Komandantit të Repartit nr. 4030, lidhur me procedurën, auditimin e kryer, Projekt Raportin e Auditimit apo Raportin Përfundimtar.

Në kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, ku parashikohet Kryerja e Auditimit të Brendshëm, Ndjekja e Procedurave dhe Raportimi e Komunikimi i Auditimit, pika 4.1.12. ndër

¹¹ Të cilën nuk e kanë vënë në dispozicion të KMD-së

të tjera parashikohet se: “...Njësia e audituar jep komente në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në fazën e diskutimit të gjetjeve për hartimin e projekt-raportit. **Projekt-raporti, i dërgohet njësisë së audituar brenda 10 ditë pune pas përfundimit të angazhimit të auditimit. Drejtuesit e njësisë së audituar mund të bëjnë me shkrim shpjegime në lidhje me përmbajtjen e projekt-raportit brenda 10 ditë pune nga data e marrjes së tij. Audituesit arsyetojnë dhe shqyrtojnë shpjegimet plotësuese dhe në rast të gjetjes së shpjegimeve të arsyetuara, ndryshojnë ose plotësojnë pjesët përkatëse në raportin përfundimtar të auditimit. Në qoftë se subjekti i audituar nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, si dhe nuk ka kërkuar takim ballafaques me grupin e auditimit, ky i fundit i konsideron të pranuar të gjitha rekomandimet dhe me kalimin e afatit të sipërcituar dërgon raportin përfundimtar dhe pret nga subjekti i audituar plan veprimin e plotësuar nga ana e tij. Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pa pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ia dërgon subjektit të audituar.**”

Pavarësisht detyrimeve të sipërcituara, nga ana e Repartit Ushtarak nr. 4030, nuk është vënë në dispozicion asnjë provë apo argument me anë të së cilit të vërtetohet fakti se ankuesi ka qënë në dijeni të auditimit të kryer apo atij t’i jetë dhënë mundësia për të paraqitur observacionet lidhur me gjetjet e këtij raporti. Gjithashtu, rezulton se nga ana e Njesisë së Auditimit nuk është marrë asnjë masë për të analizuar rekomandimet e papranuara nga shtetasit J. Q. dhe Sh. L., por janë mjaftuar me observacionet e dërguara prej tyre për t’i përjashtuar nga përgjegjësia e përvetësimit të 2 prej gomave të cituara në Procesverbalin nr. 1, datë 19.04.2017.

Së dyti, pavarësisht faktit që në Komisionin e Ndërrimit të Gomave kanë qënë 4 punonjës, nga ana e Njesisë së Auditit, janë përjashtuar nga përgjegjësia 3 prej tyre, përkatësisht shtetasit: J. Q., Sh. L. dhe Xh. L. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Auditit J. Q. dhe Sh. L., janë përjashtuar nga përgjegjësia me pretendimin se kanë dhënë observacionet përkatëse, ndërsa përsa i përket shtetasit Xh. L., nga ana e palës ndaj së cilës është paraqitur ankesa nuk është dhënë asnjë argument pse është përjashtuar nga përgjegjësia e përvetësimit të 2 prej gomave.

Së treti, në Raportin Përfundimtar të Auditimit, veç ankuesit përgjegjës për përvetësimit e 2 gomave është edhe punonjësi A. A. i DMR-së Korçë, i cili sipas informacionit të administruar, ka qënë përgjegjës material i këtij institucioni.

Së katërti, referuar akteve të disponuara gjatë procedurës hetimore¹², konstatohet se ndër të tjera, për më shumë se një herë i është drejtuar institucionit, për ta vënë në dijeni lidhur me praktika

¹² Ankuesi në cilësinë e personit përgjegjës i ka drejtuar eprorëve të tij, shkresat poshtëcituar, ku u vë në dukje shkeljet e kryera në Repartin Ushtarak nr. 4030:

- Shkresa datë 27.09.2017, drejtuar N/Kolonel B. T., Lënda: Informacion mbi administrimin e dokumentave të shfrytëzimit dhe qarkullimit të mjeteve nëpër DMR.

- Shkresa Nr. 467 prot., datë 31.08.2017, drejtuar N/Kolonel B. T., Lënda: Informim për hedhjen e firmave të specialistit të transportit nga ana e shefit të logjistikës për shkarkimet e karburantit.

anti ligjore dhe procedura të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin në Repartin Ushtarak 4030.

Për sa më lart, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për caktimin e përgjegjësisë për përvetësimin e dy gomave dhe për mos vënien në dijeni të ankuesit lidhur me procedurën e auditimit, konstaton se ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë në raport me anëtarët e tjerë të Komisionit të Ndërrimit të Gomave.

Për sa më sipër kemi trajtim të padrejtë dhe të pabarabartë të subjektit ankues krahasuar me anëtarët e tjerë të Komisionit të Ndërrimit të Gomave.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹³ të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me standartin ligjor, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030 për shkak të denoncimit të praktikave anti ligjore dhe procedurave të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin në Repartin Ushtarak 4030.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹⁴. Në nenin 1, ligji liston një sërë

- Shkresa Nr. 466 prot., datë 30.08.2017, drejtuar N/Kolonel B. T., Lënda: Informacion mbi gjendjen aktuale teknike të zjarrfikëse dhe masat që duhet të merren për mirëfunksionimin e tyre.

¹³ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

¹⁴ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹⁵.

Në mungesë të një praktike kombëtare Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. **Pretendimi i ankuesit se shkak për diskriminimin e tij është bërë denoncimi i të praktikave anti ligjore dhe procedurave të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin në Repartin Ushtarak 4030 qëndron mbështetur, në sa më poshtë citojmë:**

- Shkresa datë 27.09.2017, drejtuar N/Kolonel B. T., Lënda: Informacion mbi administrimin e dokumentave të shfrytëzimit dhe qarkullimit të mjeteve nëpër DMR, ku ndër të tjera ankuesi vë në dijeni Komandantin e Repartit Ushtarak nr. 4030, lidhur me pasaktësitë në përllogaritjen e konsumit të karburantit.
- Shkresa Nr. 467 prot., datë 31.08.2017, drejtuar N/Kolonel B. T., Lënda: Informim për hedhjen e firmave të specialistit të transportit nga ana e shefit të logjistikës për shkarkimet e karburantit. Sipas kësaj shkrese ankuesi i është drejtuar Komandantit të Repartit Ushtarak nr. 4030, duke e vënë në dijeni ndër të tjera se shefi i logjistikës ka firmosur në emër të tij për shkarkimin e karburantit.
- Shkresa Nr. 466 prot., datë 30.08.2017, drejtuar N/Kolonel B. T., Lënda: Informacion mbi gjendjen aktuale teknike të zjarrfikëse dhe masat që duhet të merren për mirëfunksionimin e tyre.

¹⁵ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të padrejtë apo të pafavorshëm të ankuesit.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, F. Ç. i është nënshtruar një qëndrimi të padrejtë nga ana e Njësisë së Auditimit të Ministrisë së Mbrojtjes, krahasuar me anëtarët e tjerë të Komisionit të Ndërrimit të Gomave.

Nga Ministria e Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030 nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se procedura e ndjekur për caktimin e përgjegjësisë për përvetësimin e dy gomave dhe për mos vënien në dijeni të ankuesit lidhur me procedurën e auditimit kanë ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokolli 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹⁶

¹⁶ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_laë_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se:

“Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mbajtur të njëjtën frymë në Vendimin nr. 113, datë 26.08.2019, ku ka konstatuar diskriminimin e shtetasit V. H. për shkak të denoncimeve të bëra dhe konfliktit të krijuar mes tij dhe me Administratorit të Shoqërisë.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030 nuk u arrit të provohej një përlligje e arsyeshme dhe objektive e veprimeve të tyre ndaj ankuesit, lidhur me caktimin e përgjegjësisë për përvetësimin e dy gomave dhe për mos vënien në dijeni të ankuesit lidhur me procedurën e auditimit.

Në kushtet kur, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030 nuk u arrit të provohej që caktimi i përgjegjësisë për përvetësimin e dy gomave dhe mos vënia në

dijeni të ankuesit lidhur me procedurën e auditimit ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qenë e justifikuar, proporcionale dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se qëndrimi i punëdhënësit ndaj tij ishte tendencioz dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkakun e pretenduar prej tij, atë të denoncimit të praktikave anti ligjore dhe procedurave të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin në Repartin Ushtarak 4030.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, 7/1, 12, 13 nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit F. Ç., nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030, për shkak të denoncimit të praktikave anti ligjore dhe procedurave të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin në Repartin Ushtarak 4030.
2. Në referim të pikës 1, Ministria e Mbrojtjes dhe Reparti Ushtarak nr. 4030, si subjekte që kanë konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrin masa për heqjen e masës administrative të dhënë nga ana e Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe kthimin e shumës financiare të mbajtur ankuesit.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER

(Shkaku: Për shkak të denoncimit të praktikave anti ligjore)

(Fusha: Punësim)